



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:040224

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05453325

Në ankesën e

AC-I-23-0222

Paditësi/Ankuesi

Xh K, fshati R i M, Lipjan, të cilin e përfaqëson avokati Sh S, nga Lipjani.

kundër

E paditura

NSH, "Shpeztaria"(në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6215 të datës 06 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6215, i datës 06 prill 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 22 shtator 2014, përmes postës paditësi e dërgoi në DHPGJS-së një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN006-0117, të datës 20 gusht 2014, me të cilën kërkesa e paditësit e datës 10 prill 2014 për kompensim të pagave të papaguara për periudhën nga viti 2006 e deri në vitin 2012 në shumë të pa përcaktuar, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi e kundërshton vendimin e Autoriteti të Likuidimit duke pohuar se ai ka punuar në NSH në periudhën e cekur dhe se kate drejtë në pagat e papaguara. Paditësi pohon se Autoriteti i Likuidimit gabimisht ka konstatuar se kërkesa është parashkruar, andaj gabimisht ka aplikuar dispozitat materiale. Ai pohon se ishte në punë në NSH dhe se ka të drejtë në paga nga viti 2006 deri në vitin 2012, duke pohuar se me kohë është paraqitur tek Autoriteti i Likuidimit pas njoftimit të AKP-së për mundësinë e paraqitjes së kërkesave. Bashkë me ankesë ai ka dorëzuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe kopjen e autorizimit të avokatit, por jo edhe ndonjë provë tjetër për t'i mbështetur pretendimet e cekura në ankesë.

Me datë 10 tetor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se vendimi i ankimuar nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit të AKP-së, prandaj nuk ka bazë ligjore të shfuqizohet vendimi i ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se NSH "Shpeztaria" ka hyrë në procedurë të likuidimit me datë 03 mars 2014, dhe të gjithë punëtorëve me këtë datë u është ndërprerë marrëdhënia e punës, prandaj punëtorët kërkesat për paga është dashur ti kërkojnë më së voni 3 vite nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. AKP-ja pohon se ajo nuk ka asnjë dëshmi se paditësi i ka kërkuar këto paga para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent në afat prej 3 vitesh, andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë, 26 tetor 2022, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS, dhe përgjigjet në mbrojtje në ankesë të AKP-së. Me këtë parashtresë ai prapë i kundërshton pretendimet e AKP-së për parashkrim të kërkesës, ndërsa i referohet nenit 194 të LMD-së, lidhur me pasurimin pa bazë të NSH-së. Në parashtresë ai kërkon edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Me datë 06 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-6215, ankesën e paditësit e refuzon si të pa bazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë konstaton se paditësi me ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH-ja i ka mbetur borxh për pagat e kërkuara për periudhën 2006-2012 dhe as dëshmi se ai ka ofruar shërbime punë për NSH-në në këtë periudhë. Andaj në mungesë të këtyre dëshmive është refuzuar ankesa si e pa bazuar, dhe është vërtetuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, meqë ai nuk ka dëshmuar të drejtën në paga sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Me datë 13 prill 2023, paditësi përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-6215, të datës 06 prill 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e dhëna në Aktgjykim. Tutje paditësi pohon se është shkelur neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 160 i LPK-së. Paditësi pretendon se gjykata nuk i ka zbatuar kërkesat e paragrafit 4 të nenit 160 të LPK-së, duke dështuar të tregojë se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar. Tutje në ankesë ai pohon se në NSH "Shpeztaria" dhe "Peshkataria" ka filluar punën para vitit 1990, pastaj për shkak të presioneve politike dhe diskriminimit të përkatësisë etnike pohon se i është pushuar marrëdhënia e punës, ndërsa pas vitit 1999, ai pohon se ka vazhduar punën në këtë NSH deri në kohën kur Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën për paga. Tutje ai pohon se kërkesën e ka paraqitur në momentin kur ka filluar likuidimi i NSH-së, ndërsa AKP-ja ka qenë e njoftuar për moskryerjen e këtyre obligimeve në raport me paditësin. Tutje ai pretendon se në këtë rast kemi të bëjmë me pasurim të pa bazë në favor të NSH-së, e cila menaxhohet nga AKP-ja. Në ankesë paditësi pretendon se asnjëherë AKP-ja nuk e ka njoftuar palën ankuese me ndonjë veprim formal lidhur me kërkesën e tij që të realizohet brenda afatit të caktuar. Nga këto arsye ai ka kërkuar që të aprovohet ankesa dhe ti njihet e drejta në paga të pretenduara ndaj NSH-së.

Me datë 16 qershor 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 10 pill 2014, e dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2012, në shumë të papërcaktuar, nga NSH "Shpeztaria" (në likuidim) është refuzuar si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë, ka dorëzuar vetëm Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe autorizimin e avokatit, dhe asnjë provë tjetër.

Po ashtu edhe me ankesën e tij në shkallën e dytë nuk dorëzon asnjë provë të vetme. Paditësi nuk ka dorëzuar Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, nuk ka dorëzuar Librezën e punës, dhe as ndonjë Listë të pagave të pa paguara të lëshuara nga NSH-ja e paditur. Paditësi pretendon ka punuar në NSH

dhe se ka të drejtë në paga të papaguara për periudhën e cekur. Asnjë dëshmi lidhur me këto pretendime nuk janë dorëzuar në gjykatë, ndërsa barra e provës për ti vërtetuar këto pretendime në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së dhe nenit 7 të LPK-së bie mbi paditësin. Paditësi ishte i obliguar dhe ishte në interesin e tij që ta mbështet ankesën me prova të mjaftuara. Paditësi siç ka konstatuar saktë Shkalla e I-rë ka dështuar të sjellë prova në gjykatë për ti mbështetur pretendimet e tij të cekura në ankesë.

Prandaj me të drejtë shkalla e I-rë e DHPGJ-së e kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar, dhe e kishte vërtetuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Nga këto arsye, ankesa e paditësit është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi me ankesën në Shkallën e I-rë dhe as tek Autoriteti i Likuidimit, nuk ka përcaktuar ndonjë shumë në emër të pagave të pa paguara, si rrjedhojë gjykata nuk i ka dorëzuar as vërejtje për taksë. Rrjedhimisht nga këto arsye Kolegji i Apelit nuk e ngarkon këtë ankues për pagesën e taksës gjyqësore për procedurën ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
